

INFORMACIONI KRYESOR PËR INVESTITORIN

Ky dokument paraqet informacionin kryesor për investitorin në lidhje me Fondin e Investimeve CREDINS PREMIUM dhe nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohet me ligj, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe rreziqet që shoqërojnë investimin në këtë fond. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo.

Investitorët në fond janë të ekspozuar ndaj rrezikut që mbartin asetet në fond. Rreziku nuk mund të shmanget asnjëherë plotësisht, pasi në situatë tregu të tensionuara apo të jashtëzakonshme investitori mund të humbasë kapital për periudha kohore të shkurtra ose të gjata, por rreziku mund të reduktohet duke zbatuar procedurat e përshtatshme për administrimin e tij. Kuotat e Fondit nuk janë depozita dhe nuk janë të siguruar nga skema e sigurimit të depozitave, investimi në Fond nuk është një investim i garantuar. Fondi nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetit e vlerës neto të aseteve dhe risku i humbjes së principalit duhet të përballohet nga investitori.

Fondi Credins Premium – Sipërmarrje Investimesh Kolektive me ofertë publike, e veçantë dhe me pjesëmarrje të hapur, e administruar nga Credins Invest sh.a.– Shoqëri Administruese e Fondeve.

OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT E INVESTIMIT

Objekti

Objekti i investimit të Fondit është të maksimizojë të ardhurat totale nëpërmjet menaxhimit efektiv të portofolit të aseteve duke ruajtur principalin dhe likuiditetin.

Kategoritë kryesore të investimit

Portofoli i Fondit CREDINS PREMIUM përbëhet kryesisht nga tituj borxhi me të ardhura fikse të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të denominuara në Lek, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë. Maksimizimi i fitimit do të realizohet duke investuar 50-90% të fondit në obligacione afatgjatë të Republikës së Shqipërisë. Stabiliteti i principalit vjen nga rreziku i ulët i kreditit dhe i tregut që karakterizon këto instrumenta. Likuiditeti do të sigurohet duke investuar deri në 20% të Fondit në depozita dhe instrumente të tregut të parasë që kanë likuiditet të lartë.

Për qëllim të diversifikimit të portofolit, Fondi mund të investojë deri në 10% të aseteve në instrumente likuide siç janë kuotat e fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur, të cilat janë të licencuara nga AMF, portofolet e aseteve të cilave kanë risk dhe luhatshmeri të ngjashme me indikatorët e Fondit. Fondi për të arritur diversifikimin mund të investojë deri në 10% të aseteve të tij në tituj borxhi të transferueshëm të kompanive apo njësisve vendore me seli në Republikën e Shqipërisë. Fondi mund të nënshkruajë kontrata derivative vetëm për qëllime të mbrojtjes nga risqet ndaj të cilave ai ekspozohet.

Për më tepër informacion rreth politikës dhe limiteve të investimeve ju lutem referojuni seksionit "Politika e Investimeve", në Prospektin e Fondit Credins Premium.

Performanca e Fondit

Performanca e fondit ndikohet kryesisht nga ecuria e normave të interesit të instrumentave financiare në të cilat fondi investon. Fondi investon vetëm në klasat e aseteve të përmendura më sipër, dhe jo në investime të veçanta të lejueshme. Kostot e transaksioneve të portofolit nuk kanë një ndikim material mbi performancën e fondit.

Monedha bazë e Fondit

Monedha bazë e Fondit është Lek. Investimet dhe shlyerjet bëhen në Lek.

Politika e shpërndarjes

Të ardhurat nga Fondi ri-investohen dhe nuk shpërndahen.

Shitja e kuotave

Investitori mund të shlyejë/shesë kuota/aksione në çdo kohë në bazë të kërkesës së tij, dhe Fondi ka një periudhë maksimale prej 7 ditësh për përbushjen e kësaj kërkesë.

Kohëzgjatja e investimit

Rekomandohet që afati minimal për investimin në Fond të jetë të paktën 2 vjet. Ky Fond mund të mos jetë i përshtatshëm për investitorët të cilët planifikojnë të shlyejnë kuotat e tyre brenda afatit 2 vjeçar.

PROFILI I RREZIKUT DHE PËRFITIMIT

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Historikisht këto norma kanë treguar luhatshmëri të ulët.

Treguesi i rrezikut sintetik dhe përfitimi

Rrezik i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë

Përfitimet tipike më të larta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Treguesi i rrezikut sintetik dhe përfitimit përdoret për të paraqitur ndaj investitorëve luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në performancën e kaluar të tij. Treguesi paraqitet me një numër të plotë, për të renditur fondin me nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të luhatshmërisë së rikthimeve historike të fondit. Kategoria më e ulët nuk do të thotë se investimi është pa risk.

Fondi CREDINS PREMIUM ka një profil të ulët rreziku, në nivelin 2, por kjo nuk do të thotë që është pa rrezik. Kategoria 2 përbën një rrezik sintetik, i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e rikthimeve që ka pasur Fondi. Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të rregulloreve për fondet me të dhënat historike për të përfshirë një periudhë kohore për 5 vite. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen. Fondi ka aktualisht nivelin 2 te riskut sintetik duke qene se asetet e Fondit jane te investuara kryesisht ne tituj borxhi te emtuar nga Republika e Shqipërisë, të cilat si tituj sovran kanë luhatshmëri dhe rrezik të ulët. Kategoria e profilit të riskut sintetik mund të ndryshojë në të ardhmen dhe nuk mund të përbëjë siguri të plotë për nivelin e rrezikut në periudhën e ardhshme. Shoqëria mund të nënshkruajë kontrata derivative sipas mundësisë të krijuara nga tregu, për tu mbrojtur ndaj normave të interesit me qëllim uljen e volatilitetit të rikthimeve ditore të Fondit.

Karakteristikat e rrezikut të aseteve në Fond

Depozitat Bankare - përmbajnë rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e riçmimit në momentin e maturimit të saj. Rreziku i riçmimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

Obligacionet dhe Bonot Qeveritare - janë të emetuara nga qeveritë, agjencitë apo ndërmarrje të sponsorizuara nga qeveritë. Qeveritë nuk garantojnë pagesën e interesit apo principalit. Obligacionet apo Bonot qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti ("rating") të ndryshme. Bonot përmbajnë rrezik nga interesat më të lartë se obligacionet me të njëjtën kohë deri në maturim.

Obligacionet dhe Bonot e Organeve Vendore të Republikës së Shqipërisë - mbartin rrezikun e kredisë të institucioneve vendore që emetojnë këto tituj borxhi. Rreziku i kreditit i organeve vendore varet nga besueshmëria dhe aftësia paguese, që rrjedh nga vjelja e taksave vendore.

Obligacionet dhe Bonot korporative - përmbajnë rrezikun e kreditit që mbart kompania që emeton këto tituj borxhi, dhe vlerësohen si me rrezik më të lartë krediti se titujt e borxhi të emtuar nga Republika e Shqipërisë. Këto asete përfaqësojnë një pjesë të vogël të portofolit të Fondit.

Alokimi në deri 10% në këtë klasë aseti mund të kryhet vetëm me qëllimin e diversifikimit pa ndryshuar thelbësisht karakteristikat e rrezikut total të fondit. **Kuota të fondeve të investimeve** - Investimi në këto asete mbart rrezikun e aseteve të mbajtura nga këto fonde dhe strategjisë së tyre të investimit. Investimi në kuota do të kryhet me kushtin që portofolet e këtyre fondeve të kenë karakteristika të ngjashme të luhatshmrisë dhe riskut sintetik me Fondin Premium. Investimi në këtë instrument financiar do të përbëjë jo më shumë se 10% të aseteve të fondit në një fond të vetëm dhe do të përdoren kryesisht për diversifikimin e portofolit.

*Për më tepër informacion rreth rreziqeve të Fondit, ju lutem referojuni seksionit "Faktorët e Rrezikut" në Prospektin e Fondit.

Rreziqet që nuk paraqiten mjaftueshëm nga treguesi sintetik

Rreziqet që nuk janë të përmbledhura në kategorinë e rrezikut sintetike janë:

Rreziku i kreditit - mund të ndodhë kur emetuesi i ndonjë obligacioni apo bonoje nuk është i gatshëm të paguajë interesin apo principalin në kohë. Obligacionet dhe bonot zotërojnë një spektër gradash që përfaqësojnë rrezikun e kredisë.

Rreziku likuiditetit - obligacionet dhe bonot e Republikës së Shqipërisë nuk mund të tregtohen në çdo kohë apo do tregtohen me çmime jo të favorshme;


Rreziku operacional - lind nga gabime të sistemeve ose gabime njerëzore të shoqërisë administruese;

Rreziku i palës tjetër - ndodh kur një pagesë nuk kryhet apo kryhet me vonesë në një sistem transfertash, për shkak të moszbatimit të kushteve të paracaktuara.

KOSTOT DHE TARIFAT E SIK

Komisionet/tarifat e SIK	
Komisionet / tarifat që paguani përdoren për të shlyer kostot e administrimit të SIK, përfshirë kostot e marketimit dhe shpërndarjes së tij. Këto komisione ulin rritjen e mundshme të investimit tuaj	
Komisione / tarifa të njëhershme përpara ose pas investimit	Komisioni i hyrjes - 0% Komisioni i largimit - 0%
Komisionet / tarifat të vazhdueshme që mbahen nga SIK gjatë periudhës së një viti	Tarifa e Administrimit: 1% në vit e VNA të Fondit
Komisionet / tarifat të tjera të vazhdueshme	Këto tarifa vjetore të vazhdueshme do bazohen në shpenzimet e fundit të vitit dhe se kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa e kostos së administrimit dhe të gjitha kostot e tjera të listuara në një vit kontabël nuk do të tejkalojnë në asnjë rast maksimumin prej 1.5% të vlerës neto të aseteve të fondet.
Tarifa e depozitarit Tarifa e Auditimit Tarifa e AMF Komisionet e brokerave për shit / blerjet e Fondit Kostot e komunikimeve me investitorin	
Komisionet/tarifat që paguhen nga Investitori:	
• Kosto shërbimi për investitorin për lëshim çertifikata dhe vërtetimesh të posaçme; • Kosto të transaksioneve bankare të pagesave për klientët;	
Komisionet/tarifat e mbajtura nga SIK në kushte të veçanta	
Komision / Tarifa e performancës: 0%	
Për më shumë informacion për komisionet dhe tarifin, ju lutemi referojuni seksionit "Komisionet dhe shpenzimet" të Prospektit të Fondit Credins Premium, të cilin mund ta gjeni në faqen e internetit të Shoqërisë: www.credinsinvest.com/dokumentacioni	

PERFORMANCA E KALUAR



Fondi ka filluar aktivitetin më 1 Korrik 2016. Norma e kthimit e paraqitur për vitin 2016 i perket vetëm periudhës 5 - mujore, 1 Gusht – 31 Dhjetor 2016. Norma neto vjetore përfaqëson normën e kthimit të portofolit pasi janë zbritur kostot dhe tarifin që i mbahen fondit. Të dhënat historike paraqiten për qëllime ilustrative dhe nuk duhet të konsiderohen si garanci për të ardhmen. Fondi mbahet në monedhën vendase Lek.

INFORMACIONI PRAKTIK

- Depozitari i Fondit të Investimit CREDINS PREMIUM është Banka Amerikane e Investimeve sh.a.
- Informacioni i mëtejshëm rreth CREDINS PREMIUM do të sigurohet nga Prospekti. Raportet periodike, të dhënat ditore mbi ecurinë e Fondit, si çmimi i kuotës dhe vlera neto e aseteve, publikohen çdo ditë në faqen zyrtare të Shoqërisë: www.credinsinvest.com.
- Prospekti i Fondit, Raport periodike dhe Pasqyrat Financiare vjetore / të ndërmjetme janë në dispozicion të investitorit pa pagesë dhe publikohen në faqen zyrtare të Shoqërisë: www.credinsinvest.com.
- Legjislacioni tatimor mund të ketë një ndikim në tatimin personal të investitorit.
- Shoqëria Credins Invest sh.a. është përgjegjëse e vetme për çdo informacion/deklaratë të përfshirë në këtë dokument që është çorientues, i pasaktë ose në kundërshtim me pjesët përkatëse të prospektit të SIK.

Fondi CREDINS PREMIUM u themelua me vendimin nr. 86, datë 30/05/2016 nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Republikën e Shqipërisë. CREDINS INVEST SH.A. - Shoqëria Administruese e Fondeve është e licencuar në Republikën e Shqipërisë dhe rregullohet nga AMF. Shoqëria ka si objekt të saj veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar, të aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe të fondeve të investimeve alternative, mbështetur në licencën me nr. 3, datë 30.05.2016, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Ky dokument me informacionin kryesor për investitorin është i saktë në datën e publikimit, Shtator 2021.